



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut  
Opština Kacanik  
Municipal Kacanik

**01– Nr. 01-16-11637/2011.**  
**Kaçanik; 29.09. 2011.**

Në mbështetje të nenit 12.1 dhe 12.2(c) lidhur me nenin 40.2(a) dhe (g) të Ligjit nr.03/L-040 – Për Vetëqeverisjen Lokale, të nenit 11 të Ligjit Nr. 3/L-204 - Për Tatimin në Pronën e Palujtshme në Kosovë, të datës 07.10.2010, të nenit 2 dhe 9 të Ligjit nr.03/L-049 – Për Financat e Pushtetit Lokal, të nenit 34.5 lidhur me nenin 61 të Statutit të Komunës, me Rekomandim të KPF-a prej datës: 22.09.2011 për aprovimin e Rregullorës për vendosjen e tatimit në pronë në territorin e komunës së Kaçanikut për vitin 2012, të propozuar nga Kryetari i Komunës në prej datës 13.09.2011, Kuvendi i Komunës Kaçanik, në mbledhjen e vet të mbajtur më datë: 29.09.2011, e aprovoj ;

**R R E G U L L O R E N**  
**PËR VENDOSJEN E TATIMIT NË PRONË NË TERRITORIN**  
**E KOMUNËS SË KAÇANIKUT, PËR VITIN 2012**

**Neni 1.**

Duke u bazuar në nenin 7. të Ligjit Nr. 3/L-204 - Për Tatimin në Pronën e Palujtshme në Kosovë, për vitin 2012 shkallët (tarifat) e tatimit në pronën e palujtshme në bazë vjetore për komunën e Kaçanikut do të jenë prej 0,05% deri 0,20%, më sa vijon:

| <b>P ë r s h k r i m i</b>                                   | <b>Norma</b> |
|--------------------------------------------------------------|--------------|
| 1. Pronat Rezidenciale – shtëpi                              | 0.10%        |
| 2. Pronat Rezidenciale – banesë / apartman                   | 0.10%        |
| 3. Garazhat                                                  | 0.10%        |
| 4. Pronat Komerciale                                         | 0.20%        |
| 5. Pronat Industriale                                        | 0.20%        |
| 6. Pishinat                                                  | 0.20%        |
| 7. Fushat sportive ( të mbuluara )                           | 0.20%        |
| 8. Pronat Bujqësore                                          | 0.05%        |
| 9. Pronat e paluajtshme e braktisur dhe objektet e pabanuara | 0.05%        |
| 10. Pronat e papërfunduara                                   | 0.10%        |

### Neni 2

Duke u bazuar në vendndodhjen e pasurisë (objekteve) e cila ndikon dukshëm në vlerën e saj, si dhe vlerësimeve nga grupi punues, në Komunën e Kaçanikut janë të përcaktuar katër (4) zona, e të cilat paraqesin ndryshime të theksuara në vlerën e pasurisë.

### Neni 3

**3.1.** Katër (4) zonat në territorin e komunës, të përcaktuara sipas kësaj rregullore, janë ndarë si më poshtë:

- Qyteti i Kaçanikut duke përfshirë edhe fshatin Bob, është i ndarë në tri (03) zona të vlerësimit, përkatësisht në Zonën e I, II dhe III-të;
- Zona e III-të përfshinë këto fshatra: Bajnicë, Begracë, Biçec, Doganaj, Duraj, Elezaj, Gabricë, Gajre, Gërllicë e Epërme, Kaçaniku i Vjetër, Koxhaj, Dubravë, Malësi, Nikë, Gllloboçicë, Runjevë, Soponicë, Stagovë, Kovaçec; dhe
- Në zonën e IV-të përfshihen këto fshatra: Sllatinë, Drenogllavë, Shtrazë, Ivajë, Kërbliq, Gjurgjedell, Kotlinë, Nikoc dhe Semajë;

**3.2.** Të gjitha objektet në parcelat të cilat gjinden pranë rrugës magjistrale Prishtinë – Shkup në tërë territorin e komunës dhe të cilat kanë çasje të drejtpërdrejt, përfshihen në zonën e I-rë, si dhe ato në pjesën e rrugës regjionale Fusha e Pajtimit – Tetovë, deri te udhëkryqi për Prizren.

### Neni 4.

Në bazë të shqyrtimit të kontratave të shitëblerjes dhe studimeve të hollësishëm të parametrave tjerë relevantë, është nxjerr vlera e tregut për të gjitha llojet e objekteve duke i klasifikuar në katër (04) zona të vlerësimit, e të cilat ndryshojnë nga viti paraprak.

#### **Norma aplikuese sipas zonave dhe vlerës së tregut në €/m<sup>2</sup> :**

|            | 0,10%         |                    |          | 0.20%                 |                    | 0,20%    | 0,20%           | 0,05%            | 0,05%                                      | 0,10%                   |
|------------|---------------|--------------------|----------|-----------------------|--------------------|----------|-----------------|------------------|--------------------------------------------|-------------------------|
| Zona       | Shtëpi banimi | Apartment - Banesë | Garazhat | **/ Pronat komerciale | Pronat Industriale | Pishinat | Fushat Sportive | Pronat Bujqësore | Pronat e braktitura & objektet e pabanuara | */ Pronat e përfunduara |
|            | 1             | 2                  | 3        | 4                     | 5                  | 6        | 7               | 8                | 9                                          | 10                      |
| <b>I</b>   | 360           | 360                | 150      | 700                   | 200                | 140      | 125             | 120              | -                                          | 144                     |
| <b>II</b>  | 300           | 300                | 120      | 500                   | 200                | 125      | 110             | 100              | -                                          | 120                     |
| <b>III</b> | 240           | -                  | 100      | 360                   | 150                | 110      | 95              | 80               | -                                          | 96                      |
| <b>IV</b>  | 180           | -                  | 80       | 300                   | 150                | 95       | 85              | 80               | -                                          | 72                      |

*\*/ Për kolonën 10. jemi bazuar në nenin 16. të Udhëzimit Administrativ nr.03/2011 - Për mbledhjen dhe regjistrimin e informatave mbi pronën dhe tatimpaguesi, ku në mënyrë decizive precizohet se të gjitha objektet e papërfunduara duhet të tatimohen me 40% të vlerës së tregut të objekteve të banimit dhe në llogaritje të tatimit nuk do të përfshihet zbritja prej 10,000 €; dhe*

*\*\*/ Të gjitha objektet e destinuara për komerciale të cilat nuk zhvillojnë afarizëm, duhet të tatimohen me 70% të vlerës së tregut të objekteve komerciale ( kolona 4).*

**Neni 5.**

Pronat të cilat lirohen nga Tatimi në Pronë, e të cilat janë të cekura në nenin 8. të të Ligjit Nr. 3/L-204 - Për Tatimin në Pronën e Palujtshme në Kosovë, lirohen nga tatimi edhe në Komunën e Kaçanikut.

**Neni 6.**

Shtyrja e pagesës së Tatimit në Pronë në kushte të veçanta, mund të bëhet konform të nenit 16. pika 1. të Ligjit Nr. 3/L-204 - Për Tatimin në Pronën e Palujtshme në Kosovë

**Neni 7.**

Në pajtim me nenin 11 pika 1.4. të Ligjit Nr. 3/L-204 - Për Tatimin në Pronën e Palujtshme në Kosovë - “Përgjegjësitë Komunale”, Krytari i komunës për vitin 2012 emëron Bordin e pavarur komunal për shqyrtimin e ankesave administrative të tatimpaguesëve, në përbërje prej tre (03) anëtarëve.

**Neni 8.**

**Ligjit Nr. 3/L-204- Për Tatimin në Pronën e Palujtshme në Kosovë dhe Udhëzimet Administrative**, rregullojnë të gjitha çështjet tjera që kanë të bëjnë me Tatimin në Pronë, e të cilat nuk janë përfshirë në këtë rregullore komunale.

**Neni 9.**

Kjo Rregullore hynë në fuqi në ditën e aprovimit nga ana e Kuvendit të Komunës dhe e njejta do të zbatohet për vitin 2012.

**Kryesuesi i Kuvendit,  
z. Xhelal Gashi,**

---